REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVATË
Shoqeria "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. Nipt L81722046V
Rruga "Vaso Pasha" Nr.13/1, Ap.1, Tirane E-mail: elvinth@hotmail.com Mob: +355682029920

Nr.208 Dosje
Nr.3707 Prot.

Tiranë më datë.12/7/2018

**URDHËR**
(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE
DUKE NDALUAR TJETERSIMIN E ADMINISTRATORIT)

QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT Nr. 8294 Prot. Date 16 7 2018

**Drejtuar** : QËNDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT
**Per Dijeni :** Debitorit , **Shoqërisë "MEDIA NORD" sh.a Nr.Nipt K66531001W**
Kreditorit, **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**

Unë Elvin Gëzim Hoxha me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në referim të Vendimit për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.Regj.Them 1196 (31134-04488-80-2017) datë 24.07.2017 lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për Titullin Ekzekutiv Vendim Gjobë Nr.41, datë 27.04.2017 të Drejtorisë së Mbikqyrjes së AMA-s,, kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.208 , Datë 09.10.2017 kërkesën e pales kreditore **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)** ndaj debitorit **Shoqërisë "MEDIA NORD" sh.a Nr.Nipt K66531001W për subjektin televiziv "TV CHANNEL 1" me administrator Ermir Hysni Bebeziqi.**

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr. 3781 Prot, Datë 09.10.2017 , për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që permban titulli ekzekutiv , kamtëvonesaligjore sëbashku me tarifën e plotë të shërbimit përmbarimor , në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOVA SE**

Më datë 12.07.2018 pala kreditore Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka paraqitur pranë Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k shkresën Nr.3075 Prot datë 12.07.2018 ku kërkohet rifillimi I ekzekutimit të Titullin Ekzekutiv Vendim Gjobë Nr.41, datë 27.04.2017 të Drejtorisë së Mbikqyrjes së AMA-s , pezulluar me Vendimin Nr.4232 Prot datë 03.11.2017 të përmbaruesit gjyqësor Elvin Hoxha bazuar në kërkesën e pales kreditore.

**Sa më sipër në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe ligjit nr.10031 , datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat" si dhe Nenit 39 te Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010" Per Kundervajtjet Administrative"**

**URDHEROJ :**

1-Vendosjen e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore **Shoqëria "MEDIA NORD" sh.a Nr.Nipt K66531001W për subjektin televiziv "TV CHANNEL 1"me administrator Ermir Hysni Bebeziqi** , si dhe mbi te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i ketyre kuotave duke ndaluar tjetersimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnje veprimi tjeter i cili mund te ndryshoje te dhenat ne regjistrin tregtar si dhe duke ndaluar tjetersimin e administratorit z. **Ermir Hysni Bebeziqi** . Dokumentacioni do te qendroje i bllokuar deri ne nje urdher te dyte nga Permbaruesi Gjyqesor Elvin Hoxha .

**Debitori : Shoqëria "MEDIA NORD" sh.a identifikuar me Nr.Nipt K66531001W për subjektin televiziv "TV CHANNEL 1" me administrator Ermir Hysni Bebeziqi me adrese te ushtrimit te aktivitetit : Lagjja Qemal Stafa pranë TV1 Shkodër.**

2- Per veprimet apo mos veprimet tuaja duhet te na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor

3- Personat qe behen pengese , do te pergjigjen ne baze te nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) qe parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallezimit penal.
4- Ky urdher mbahet ne disa kopje dhe u njoftohet paleve te cilat kan te drejten e ankimit ne Gjykate brenda 5 (pese) diteve.

**SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "BAILIFF SERVICE E.HOXHA"sh.p.k.**
**PËRMBARUES GJYQËSOR**
**ELVIN HOXHA**